



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:022426

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05495998

P.nr.298/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe praktikanten gjyqësore Bleontina Kameri, në çështjen penale kundër të pandehurit A.C nga ..., në rrugën ..., nr. ..., për shkak të veprës penale vetëgjyqësia, nga neni 410 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.4358/20 të datës 05.02.2021, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 21.03.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Avni Namani, të pandehurit A.C dhe mbrojtëses së tij av. ..., me datë 22.03.2024 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 25.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

A.C, nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë se nënës ..., i lindur ... në P., ku edhe banon, ..., i pa martuar, punon, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 10.04.2020 rreth orës 01:00, në lokalin ... e cila gjendet në rrugën ..., i pandehuri nga pozita e të punësuarit si shpërndarës i picave ka ushtruar një të drejtë në mënyrë arbitrare në vend që ti drejtohet organit kompetent dhe me këtë rast nga arka e lokalit ka tërhequr shumën e parave në vlerë prej 700 euro, me arsyetimit të mos pagesave të pagave të tij.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *vetëgjyqësia, nga neni 410 par.1 të KPRK-së*.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 69, 70, 81, 82, nenit 410 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364, si dhe 449 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Të pandehurit A.C. i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

I dëmtuari ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I pandehuri obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzet (20) Euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP/II.nr.4358/20 të datës 05.02.2021 të pandehurin A.C e ka akuzuar për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 21.03.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë prezent ishin Prokurori i Shtetit Avni Namani, i pandehuri A.C dhe mbrojtësja e tij av. ...

Para se të lexohet aktakuza, Prokurori i Shtetit e bënë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale keqpërdorim i besimit, nga neni 330 par. 1 të KPRK-së, në veprën penale vetëgjyqësia, nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, duke ndryshuar edhe përshkrimin e gjendjes faktike si në aktakuzë.

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat konform nenit 241 par. 1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtit i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm për veprën penale të ricilësuar.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri pas sqarimeve të nevojshme nga ana e gjykatës dhe në prezencën e mbrojtëses së tij deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat e këtij pranimi, duke shtuar se ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur, kërkon falje, se ka qenë i vetmi anëtar mbajtës i familjes dhe si rrjedhojë e kësaj është detyruar të ndërmarr veprime për të cilat ka menduar se i takojnë, është hera e parë që dal para gjykatës dhe i premtonte gjykatës se më nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme.

Pasi që i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, konform nenin 242 par.5 të KPP-së gjyqtari ka marrë mendimin e mbrojtëses së të pandehurit dhe Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Mbrojtësja e të pandehurit av. ...,ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme dhe njëherit ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë. Ndërkaq, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë dhe faktin se është mbajtës i familjes, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shqiptohet një dënim sa më i butë, e në rast se i shqiptohet dënim me burgim, i njëjti t'i zëvendësohet në dënim me gjobë.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitës ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe është në harmoni të plotë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj i ka propozuar gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë, të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Ndërkaq me rastin e shqiptimit të dënimit, ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa rrethanë rënduese nuk ka gjetur.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPP-së dhe në pajtim me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike, po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjykuese u bind se i pandehuri e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 par. 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale vetëgjyqësia, nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e sanksionit penal.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprës penale vetëgjyqësia, nga neni 410 par.1 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj sanksionin penal vërejtje gjyqësore, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal. Si rrethanë lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i akuzuari për veprën penale për të cilën akuzohet, shprehjen e keqardhjes për rastin që ka ndodhur, bashkëpunimi i tij me gjykatën, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, është familjar dhe mbajtës i familjes, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe premtimin se më nuk do të përsërisë këtë veprë penale, ndërsa si rrethanë rënduese përveç shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, gjykata rrethanë tjetër rënduese nuk ka gjetur.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj vërejtje gjyqësore sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Gjykata përkitazi me sanksionin penal mori për bazë pranimin e fajësisë, karakteristikat personale të të pandehurit se i njëjti asnjëherë tjetër nuk ka rënë ndesh me ligjin, se është mbajtës i familjes, premtimin se më nuk do të përsërisë këtë veprë penale dhe keqardhjen e shprehur në shqyrtim fillestar për veprën e kryer penale. Gjykata me këtë sanksion penal konsideron se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari është i bindur se vërejtja gjyqësore e shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht sanksioni penal i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky sanksion do të shërbejë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, ku të dëmtuarin, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontestin e rregullt juridiko civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet euro) €. Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.298/21 datë 25.03.2024

Praktikantja gjyqësore

Bleontina Kameri

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.